VENDIM
Nr. 1047, datë 16.12.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE "AT ZEF PËLLUMBI", NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË

(ndryshuar me VKM nr. 282, datë 12.5.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "At Zef Pëllumbi", Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në vlerën 226 500 000 (dyqind e njëzet e gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "At Zef Pëllumbi", Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, do të jetë në vlerën 45 300 000 (dyzet e pesë milionë e treqind mijë) lekë pa TVSH dhe do të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.

2.1 Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 181 200 000 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e dyqind mijë) lekë pa TVSH dhe i transferohet Bashkisë Lezhë për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "At Zef Pëllumbi", Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare "At Zef Pëllumbi", Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "At Zef Pëllumbi", i transferohet njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe